



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Praktikë Profesionale 1

Ngarkesa: 4 kredite : 80 orë praktike

Viti / Semestri : Viti I, semestri II

Programi i studimit: Master i shkencave në “Komunikim ndërkulturor dhe turistik trigjuhësh”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme lëndore: Praktika profesionale synon të ofrojë një përvojë të pasur dhe cilësore për studentët, duke i përgatitur ata për sfidat dhe mënyrat e punës në fushën e komunikimit ndërkulturor dhe turistik.

Objektiva specifike lëndore:

1. Të zhvillojnë njohuritë praktike: praktika u ofron studentëve një mundësi për të zbatuar njohuritë teorike që kanë fituar në klasë në një kontekst praktik. Ata duhet të mësojnë të përdorin instrumente të komunikimit, strategji, dhe teknika të komunikimit turistik dhe kulturor në praktikë të vërtetë.
2. Të përmirësojnë aftësitë komunikuese shumëgjuhëshe: për të konceptuar dhe hartuar artikuj, materiale promovuese, raporte dhe për të komunikuar me audiencën dhe klientët në një mënyrë efektive dhe tërheqëse.
3. Të njohin sektorin turistik dhe ndërkulturor: praktika do të ndihmojë studentët të kuptojnë sektorin turistik dhe kulturor, përfshirë trendet, sfidat, dhe mundësitë aktuale. Ata duhet të mësojnë se si funksionojnë organizatat, institucionet, dhe agjencitë në këtë sektor.

Rezultate të pritshme:

1. të kuptojnë më mirë kulturat e ndryshme, pritshmëritë e turistëve nga prejardhje të ndryshme dhe ndikimin e kulturës në turizëm. Kjo mund të përfshijë njohuri për dallimet kulturore, traditat dhe zakonet.
2. Të komunikojnë në mënyrë efektive me njerëz nga kultura të ndryshme. Kjo shpesh përfshin zotërimin e disa gjuhëve të huaja, si dhe aftësinë për të përshtatur komunikimin tuaj në varësi të bashkëbiseduesit.
3. Të zhvillojnë aftësi në planifikimin, menaxhimin dhe vlerësimin e projekteve në sektorin e turizmit